



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës/Ministarstvo Obrazovanja i Nauke
Ministry of Education and Science

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e projekt-propozimeve të OJQ-ve

Prishtinë: 24/03/2026

Ministria e Arsimit dhe Shkencës gjatë vitit 2026 planifikon që përmes thirrjeve publike të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të Organizatave Jo-Qeveritare në fushat që ndërlidhen me:

1. Promovimin e projekteve të organizatave joqeveritare që menaxhojnë qendra mësimore dhe ofrojnë mësim plotësues për nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;
2. Promovimin e projekteve të organizatave joqeveritare që promovojnë nxënësit me inteligjence të jashtëzakonshme, talente dhe dhunti.

Rregullorja MF- Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Neni 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësues për vlerësimin e projekt-propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrimit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së MASH-së, do të caktohen në cilësinë e anëtarëve të komisionit vlerësues për projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar.

Aplikimi mund të bëhet jo më larg se data 01.04.2026, ora 15:00, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në zyrën nr. 4 Arkiv- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

MASH, *do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm të cilët do të ftohen sipas nevojës për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese, sipas thirrjeve publike që do të bëjë MASH gjatë vitit 2026.*